



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:138660

Datë: 03.10.2024

Numri i dokumentit: 06245847

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Dardan Maloku, në çështjen penale ndaj të pandehurit A.H nga fshati D..., Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale Vjedhja e Pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të Kodit 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tani e tutje KPRK-së), duke vepruar sipas aktakuzës se Prokurorisë Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP/II.nr.1316/2020 e datës 15.10.2020, jashtë seancës në kuptim të nenit 357 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 lidhur me nenin 235 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Kodit 08/L-032 të Procedurës Penale (tani e tutje KPP-së), më datë 03.10.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP/II.nr.1316/2020 e datës 15.10.2020, dhe **PUSHOHET** procedura penale kundër të pandehurit A.H, nga i ati B..., me vendbanim në fshatin D..., komuna Ferizaj, i lindur me datë ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-së.
- II. Shpenzimet e procedurës penale mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.
- III. Pala e dëmtuar Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm më datë 15.10.2020, ka ngritur aktakuzë me propozim për shqiptimin e urdhrin ndëshkimor ndaj të pandehurit A.H për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 të KPRK-së.

Me datë 05.01.2021, gjykata Themelore në Ferizaj ka nxjerrë Aktgjykimin P.nr.867/2020 me të cilin e ka pranuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj për shqiptimin e urdhrin ndëshkimor dhe e ka shpallur fajtor të pandehurin dhe e ka dënuar me dënim me gjobë në vlerë prej 300 euro.

Më datë 26.06.2023, kjo çështje penale ka kaluar nga gjyqtarja M.Sh. tek gjyqtari Dardan Maloku.

Neni 235 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i KPP-së, përcakton se aktakuza përmban: “*emrin dhe mbiemrin e të pandehurit dhe të dhënat e tij personale*”. Në aktakuzën e paraqitur mungojnë të dhënat personale të pandehurit siç janë: vendi i lindjes së të pandehurit, numri personal i të pandehurit etj.

Gjykata ka bërë përpjekje që ta siguroj prezencën e të pandehurit përmes të dhënave që gjenden në aktakuzë por nuk përputhen saktësisht me personin në fjalë, Gjykata ka shfrytëzuar edhe hapat të tjerë ligjorë ku ka parashtruar kërkesë Sektorit të Gjendjes Civile në Ferizaj dhe në përgjigjen e Zyrës për Gjendje Civile në Ferizaj është theksuar se për këtë qytetar nuk ka të dhëna në Programin e Gjendjes Civile.

Gjithashtu edhe me Memorandumin Zyrtar nga Policia e Kosovës Stacioni Policor në Ferizaj jemi informuar se i pandehur me të dhënat si në aktakuzë nuk ekziston dhe nuk e njeh askush në fshatin D....., komuna Ferizaj.

Më datë 21.06.2024, Gjykata e ka kthyer në plotësim aktakuzën dhe ka kërkuar nga paraqitësi i aktakuzës PP.II.Nr.1316/20 e datës 15.10.2020, që ti ndërmarr veprimet e nevojshme ligjore dhe ta bëj plotësimin e saj, pasi që në pjesën ku janë shënuar të dhënat e të pandehurit mungon

vendi i lindjes së të pandehurit dhe numri personal i të pandehurit, ashtu siç kërkohet me nenin 235 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPP-së.

Përmes parashtrësës së dorëzuar nga Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm jemi njoftuar se kallëzimi penal që është bërë nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë në Ferizaj, është bërë në bazë të shënimeve të rojës së pyllit dhe sa i përket kërkesës tuaj ne nuk kemi informata shtesë lidhur me këtë person dhe për identifikimin e këtij personi është angazhuar Policia e Kosovës – Stacioni Policor në Ferizaj dhe Zyra e Sektorit të Gjendjes Civile në Ferizaj, ku nuk është gjetur ndonjë shënim plotësues apo i saktë për këtë person.

Andaj, gjykata në kuptim të nenit 357 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 lidhur me nenin 235 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal,
2020:138661, më datë 03.10.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Dardan Maloku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 3 (tre) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Ferizaj.